

VENDIM
Nr.17, datë 13.1.1997

PËR TRAJTIMIN NGA SHTETI TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT SPECIAL PUBLIK

Në mbështetje të pikës 2 nenit 40 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fëmijët e institucioneve të arsimit special publik pa konvikt trajtohen falas nga shteti me një vakt të ushqimit (drekë) dhe me mjete shkollore (libra shkollore, fletore, lapsa, stilolapsa e të tjera materiale të kësaj natyre), sipas pikës 1 të pasqyrës që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Fëmijët e institucioneve të arsimit special publik me konvikt trajtohen falas nga shteti me ushqim e veshmbathje, sipas pasqyrës së bashkëngjitur, si dhe për materiale shkollore (libra shkollore, fletore, lapsa, stilolapsa e të tjera materiale të kësaj natyre) dhe shpenzimet për higjienën personale e argëtim.

3. Për të qenë sa më afër fëmijëve dhe për t'i ndihmuar më mirë ata, mësuesit dhe ndihmësmësuesit e institucioneve, sipas pikave 1 dhe 2, gëzojnë të drejtën të ushqehen një vakt (drekë) kundrejt pagesës së reduktuar deri në masën 50 për qind të kuotës së nxënësve.

4. Efekti ekonomik i shpenzimeve të mësipërme përballohet nga buxheti i akorduar këtyre institucioneve.

5. Pika 4.2 “gjysmëbursa” e pasqyrës nr.3 në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.654, datë 30.9.1996, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Sporteve për nxjerrjen e udhëzimit në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 1997.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT DHE VESHMBATHJES.

	Ushqimi	Veshmbathje
1. Për nxënësit e shkollave me prapambetje mendore, pa konvikt	50	-
2. Për nxënësit sipas pikës 2 të vendimit	100	4 000
3. Punonjësit mësimorë-edukativë	25	-

Shënim. Kuotat për veshmbathje janë vjetore, kurse të ushqimit ditore.